



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.566/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS –Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit EGTK II shpk me seli në Pejë, kundër të paditurës Njësia për Intelegjencë Financiare me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallë së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.253/22 të datës 25.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit EGTK II shpk me seli në Pejë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallë së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.253/22 i datës 25.10.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallë së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.253/22 i datës 25.10.2023, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit AGTK II me seli në Pejë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.DIUAD:92/2019 datës 15.04.2019, i të paditurës Njësia për Intelegjencë Financiare me seli në Prishtinë,

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë i autorizuari i paditësit për shkak të: shkeljes së dispozitave procedurale dhe materiale duke propozuar që Dhomat e shkallës së dytë, ta aprovoj në tërsi ankesën e paditësit, të anuloj në tërsi aktgjykimin e Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallë së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.253/22, dhe kjo çështe të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Njësia për Intelegjencë Financiare me seli në Prishtinë, me vendimin përfundimtar nr.FIUAD:92/2019 dates 15.04.2019, në procedurën administrative të ankesave, ka refuzuar ankesën e subjektit raportues-paditësit EGTK II me seli në Pejë, dhe ka vërtetuar vendimin FIUAD:44/2019 datës 21.02.2019 i nxjerr nga Njësia për Intelegjencë Financiare.

Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë duke inicuar konflikt administrativ kundër të paditurës Njësia për Intelegjencë Financiare me seli në Prishtinë, respektivisht ka kundërshtuar vendimin nr.FIUAD:92/2019 dates 15.04.2019 të paditues, me arsyetimin se vendimet janë të pa drejta dhe të kundërligjshme.

Dhoma e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 17.10.2023, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar si dhe pas administrimit të provave, mori Aktgjykimin e atakuar me të cilin ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata vlerësoi se përkundër faktit se paditësi ka nxjerr Rregulloren për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, por nga procesverbali i inspektimit të pajtueshmërisë dhe nga prova Kërkesë për Sqarim, vërtetohet se rregullorja nuk është zbatuar plotësisht dhe nuk i përmban të gjitha elementet e specifikuar në nenin 17 të Ligjit 05/L-096, pasi që mungon përfshirja e indikatorëve të hartuar nga NJFT. Gjithashtu rezulton se lista e indikatorëve të lëshuar nga NJFK përveç që nuk është e përfshirë në procedurën e shkruar gjithashtu rezulton se nuk është komunikuar tek punonjësit të cilët gjatë inspektimit në procesverbal, kanë deklaruar “se nuk posedojnë listë të indikatorëve të shkruar të cilës do ti referohej menaxheri i pikës i cili është kontakti i parë me lojtarin”, pra nga procesverbali i inspektimit konstatohet se punëtorët nuk kanë njohuri të mjaftueshme për obligimet ligjore për parandalimin e pastrimit të parasë dhe hulumtimin e financimit të terrorizmit. Gjithashtu gjykata konstatoi se paditësi nuk e ka përmbush obligimin nga neni 18, 19, 21 dhe 26 të Ligjit 05/L-096, andaj gjoha e shqiptuar nga i padituri nga neni 43 par.1 nenp.1.9 të Ligjit 05/L-096, është e drejtë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të dhomës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave procedurale apo ligjore, të cilat shkelje

gjkata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK).

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vlerësoi se gjatë konfliktit administrativ, dhoma e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar të paditurës, në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejt ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit EGTK II me seli në Pejë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.FIUAD:92/2019 dates 15.04.2019 të paditures NJIF-K. Kolegji vlerësoi se në arsyetim të aktgjykimit ankimor janë dhënë konstatimet faktike dhe ligjore sa i përket shkeljeve ligjore të paditësit me rastin inspektimit tek paditësi në këtë rast si subjekt raportues, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi, dhe në këtë rast dhoma e shkallës së parë me të drejt ka dhënë konstatimin se bazuar në procesverbalin e inspektimit të pajtueshmërisë, e paditura ka vepruar drejt kur në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 pika 1.9 e Ligjit 05/L-096, i ka shqiptuar paditësit ndëshkimin administrativ për shkelje të rënda,

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit, se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare, aktgjykimi nuk është i arsyetuar konform të drejtës materiale, se procesverbali i inspektimit nuk përmban elementet e detyrueshme të një akti administrativ nga neni 47 i LPPA-së pasi që nuk përmban datën kur është hartuar procesverbali, Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara në ligj dhe të argumentuara në provat e lëndës, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga dhoma e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Kolegji vlerësoi se e paditura dhe gjykata e shkallës së parë në arsyetimet e vendimeve kontestuese kanë dhënë fakte të mjaftueshme që dëshmojnë se me rastin e inspektimit, nga zyrtarët e paditures, janë gjetur një sërë parregullsi ligjore, që kanë të bëjnë me mos zbatimin në tërësi të Rregullores së nxjerr nga paditësi për parandalimin e pastrimit të parave, e nga e cila rregullore, paditësi nuk ka arrit të dëshmojë se i ka përmbush të gjitha obligimet që dalin nga kjo rregullore, si: deklarimi i puntorve të paditësit se nuk kanë njohuri për listën e indikatorve të hartuar nga NJIF-K, nuk ka të caktuar zyrtar të pajtueshmërisë, nuk ka raportues në NJIF-K, për identifikimin e klientëve, andaj mos ndëmarja e këtyre veprimeve që parashihen me ligj, duke konkretizuar specifikisht për secilën shkelje nga neni 17, 18, 19, 21 dhe 22 të Ligjit 05/L-096, Kolegji nuk i pranoi si të bazuara pretendimet e paditësit se aktgjykimi nuk është i arsyetuar konform të drejtës materiale.

Kolegji vlerësoi edhe bazën ligjore nga neni 47 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku paditësi pretendon se procesverbalit i inspektimit nuk përmban elementet e detyrueshme të një akti administrativ për shkak se nuk përmban datën e hartimit të procesverbalit. Kolegji vlerësoi se kjo dispozitë ligjore parasheh strukturën dhe elementet që duhet përmbajtur një akt administrativ: pjesën hyrëse, pjesën urdhëruese, arsyetimin dhe informatat për mjetet juridike, prandaj në këtë rast nuk është i mjaftueshëm pretendimi i paditësit pse i mungon data procesverbalit të inspektimit, pa e kontestuar fare vlefshmërinë e tij si provë materiale. Kolegji vlerësoi se procesverbalit i inspektimit, në këtë rast i nxjerr nga i padituri, është një mjet prove (neni 88 i LPPA) mbi bazën e së cilës është nxjerr gjendja faktike me rastin e inspektimit tek paditësi, në të cilin procesverbal janë dhënë deklaratat e puntorve sa i përket zbatimit të rregullores së pastrimit të parave, dhe i nënshkruar nga zyrtarët e paditësit dhe paditues, prandaj pretendimet ankimore nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar, Kolegji, konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.566/24 datë 18.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha